



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 1776 prot.

Tiranë, më 25.06.2024

NJOFTIM ME SHPALLJE

**TË VENDIMIT NR. 1939/11, DATË 23.11.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË
TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË ANKESËS SË
PARAQITUR NGA SHTETASI Z. KOL KLLAPI DHE PËRFUNDIMIN E
VERIFIKIMIT PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR TË ANKESËS LIDHUR
ME VEPRIMTARINË E ISH MAGJISTRATËVE SH.B. DHE E.LL.”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga z. Kol Kllapi me nr. 4389 prot., datë 15.12.2021, në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratëve E.GJ. me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, A.K. me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, E.P., V.H., G.SH. me detyrë gjyqtarë në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe ish magjistratëve SH.B. dhe E.LL me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë, në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 1939/11 prot., datë 23.11.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Kol Kllapi dhe përfundimin e verifikimit pa një vendim përfundimtar të ankesës lidhur me veprimtarinë e ish magjistratëve SH.B. dhe E.LL. ”, bazuar në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, nenin 122, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 204, pika 1, shkronja “j” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Instituti i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

